



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Z. Jusuf Nurkasa
Pronar
Radio Strat
R071
Rahovec

VENDIM: LIC/KPM-2013/11
Ref: 1301/199/KPM/ni

VENDIM

lidhur me ndryshimin e pronësisë së Radio Start-Rahovec

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Start është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio-Vizuale me mbulim lokal, i cili është i licencuar për të transmetuar radio programe në komunën e Rahovecit. Radio Start është pajisur nga KPM, me licencë afatgjatë të transmetimit me datën 6 tetor 2009.
3. Me datën 21 shkurt 2012, Radio Start ka dorëzuar ne zyrën e KPM-së, një kërkesë për ndryshimin e pronësisë së radio stacionit.
4. Me anë të një deklaratë, si pjesë e kërkesës për ndryshimin e pronësisë të Radio Start, pronari aktual, z. Jusuf Nurkasa, ka deklaruar se për shkak se do të kalojë për të jetuar në një shtet tjetër, nuk do të jetë më në gjendje të menaxhojë më radio stacion. Prandaj, ai ka kërkuar nga KPM, që ti lejoj transferimin e pronësisë të z. Liridon Durguti, punonjësi i kësaj radioje.
5. Poashtu z. Liridon Durguti, ka kërkuar nga KPM që ta mundësojë transferimin e pronësisë së Radio Start në emër të tij dhe se është i gatshëm të punojë në pajtim me Ligjin dhe rregulloret e KPM-së. Gjithashtu, kandidati për pronarë të ri të Radio Start ka deklaruar se do të investojë në teknologji të kësaj radioje, pasi ajo ekzistuese është e vjetruar, duke i ofruar publikut kualitet më të lartë të programit.

Arsyetimi

6. Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin i Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
7. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: “*për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja*”.

Rruga Gazmend Zajmi #1, Prishtina - Gazmend Zajmi Street #1, Prishtina - Ulica Gazmend Zajmi #1, Prishtina

t. +381 (0)38 245 031 f. +381 (0)38 245 034 e. info@imc-ko.org


8. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: “licencat nuk mund të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”.
9. Neni 5.2 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *I licencuari nuk mund të transferojë ose dorëzojë këtë licencë ose frekuenc-ën(at) e përcaktuara të saj pa miratimin paraprak me shkrim të KPM-së. Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 49% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht autorizim me shkrim nga ana e KPM-së.*
10. Neni 5.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur ajo sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t'i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t'iu dhënë një licencë.*
11. Prandaj, në pajtim me nenin 5.4 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Komisioni i Pavarur për Media, konkludon se kandidatit të propozuar për pronar t'i transferohet licenca, i përmbush standardet e kualifikimit për licencë të KPM-së.
12. Arsyetimin për bartje të pronësisë nga ana e parashtruesit të kërkesës, KPM e pranon si të mjaftueshëm dhe në shërbim të interesit publik për të aprovuar kërkesën për bartje të pronësisë.

Vendim

13. Komisioni i Pavarur për Media, vlerëson se ndryshimi i pronësisë së Radio Start nuk do të ndikojë në ndryshimin e formatit të programit dhe zonës së mbulimit.
14. Komisioni i Pavarur për Media, vlerëson se kandidati për pronarë të ri të Radio Start ka njohuri profesionale në drejtimin e radio stacionit, pasi që i njëjti ka punuar për një kohë të gjatë në këtë subjekt transmetues.
15. Komisioni i Pavarur për Media, vendos që pronësia e Radio Start të transferohet tek z. Liridon Durguti dhe licenca e Radio Start të ndryshohet.

Lëshimi i vendimit

16. Këtë vendim e lëshon KPM.


Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur për Media



28.12.2012
datë